



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:056975
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05762654

P.nr.310/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Arlind Sharani, me zyrtarin ligjor Amar Hoxha, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.I., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të KPRK-së (06/L-074), i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.398-1/22 të datës 24.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, me datë 16.05.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ramadan Koro dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 31.05.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.I., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur menë Ferizaj, ku edhe tani banon në rrugën “.....” nr....., i pa martuar, punon në kompaninë “.....”, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të personal, dhe numër të letërnjoftimit ID

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datë 08.01.2022, rreth orës 00:25 minuta, në rrugën “Presidenti Rugova”, në fshatin Malësi e Re, Komuna Prizren, me dashje dhe pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë deri sa i pandehuri e drejtonte automjetin e markës “.....” me shenjen regjistruese, që nga ana e Patrullës GLA-3, gjatë patrullimit kanë ndaluar automjetin e markës “.....”, për shkak të orës policore, dhe gjatë shiqimit të veturës nga ana e patrullës policore është vërejtur se në karrigen e përparme të pasagjerit janë gjetur filtra për mbështjelljen e narkotikve, ndërsa gjatë kontrollimit të i pandehuri janë gjetur një qese me marihuanë në peshë 0.39 gram dhe dy pako të filterave mbështjellës të marihuanës.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 paragrafi 2, të KPRK-së (06/L-74).

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17 par.1, 38, 40, 43, 47, 69, 70, dhe nenit 269 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe nenin 364 të KPPRK-së, të akuzuarin i shqipton:

D Ë N I M I N M E G J O B Ë

Në shumën prej 500€ (pesëqind euro), të cilën dënim i akuzuari obligohet ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 25 (njëzet e pesë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20€ një ditë burg.

Gjykata në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 276 par.2 pika 2.4 të KPPRK-së,

Urdhërohet-konfiskimi i dëshmisë: D#1 një (1) qese plastike me substance narkotike të llojit marihuan me peshë prej 0.39 gram, D#2 dy paketime të vogla, me ngjyrë të zezë, me mbishkrim OCB Slim+Filters dhe D#3 një (1) shufër metalike me dorëz të zezë, të cilat duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, e cila evidentohet me numër të rastit 2022-GL-008.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 20€ (njëzet euro), ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.398-1/22 të datës 24.03.2022, kundër të akuzuarit A.I., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.2 të KPRK-së (06/L-074).

I akuzuari, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se është i penduar për veprimin të cilin e ka kryer, i premtos gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të këtilla të kundërligjshme, pas kryerjes së veprës penale më nuk është përdorues i substancave psikotrope tani është duke u marr me sport, gjegjësisht kik-boks ku është duke e përfaqësuar e Republikën e Kosovës në arenën ndërkombëtare, publikisht shpreh falje për veprimet e tij.

Prokurori i shtetit Ramadan Koro, nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari duke shtuar se pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nga ana e gjykatës, ndërsa si rrethanë rënduese të merret fakti se i njëjti për vepra të njëjta apo të ngjashme ka qenë i dënuar.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se

pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari A.I., me dashje ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 paragrafi 2, të KPRK-së (06/L-74), nga neni 269 par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përkohshme si në dispozitiv të Aktgjykimit.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 269 par.1 të KPRK-së, është parashikuar forma themelore e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen: “Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet. Ndërsa, në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar forma e privilegjuar e kryerjes së veprës penale, për shkak se kryerësi është fillestar dhe sasisë së vogël të narkotikut, ku parashihet: “Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”.

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen e vërtetuar faktike, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.I., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendja e dobët ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, pranimin e fajësisë qysh në fazën fillestare dhe se pranimin e fajësisë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, se i akuzuari është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin publik që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale dhe kohës kur çështja është duke u trajtuar përfundimisht nga gjykata. Ndërsa, si rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka gjetur se i njëjti është recidivist i veprave të natyrave të ndryshme penale për të cilat është gjykuar dhe

dënuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, P.nr.972/2018, i plotfuqishëm më 22.11.2018, 2022:049220, plotfuqishëm më 12.05.2022. Prandaj duke pas parasysh të gjitha faktet, arsyet dhe rrethanat e përmendura më lartë, gjykata ndaj të njëjtit ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në lartësinë e shqiptuar duke marrë parasysh gjendjen pasurore të akuzuarit, gjegjësisht shumën e të ardhurave të mujore të cilat i realizon si punëtor, duke i analizuar të gjithë faktorët të cilët kanë ndikuar në lartësinë e përcaktimit të dënimit me gjobë, përfshirë këtu analizimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke qenë i bindur se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëj rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për konfiskimin

Vendimin mbi konfiskimin e sendeve, gjykata e mori në pajtim me nenin 269 par. 3 të KPRK-së, lidhur me nenin 276 par.2 pika 2.4 dhe 2.6 të KPPRK-së, pasi që të njëjtat sende u vërtetua se janë objekt i kryerjes së veprës penale dhe sende që janë jashtë qarkullimit juridik, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe provave të bashkëngjitura.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.310/22, me datë 16.05.2024

Zyrtari Ligjor
Amar Hoxha

Gjyqtari i vetëm gjykues
Arlind Sharani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.